



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

NGA MBLEDHJA E KATËR E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **20.05.2026 (e mërkurë)**, në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Basri Aliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj.Elsa Jahija, mungoj zn.Liridona Bislimi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se janë prezent të gjithë anëtarët e KPF-së dhe ka kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e katër të rregullt të KPF-së. Pra, materialin e keni marrë me kohë. Ju njoftoj se e kemi në rivlerësim një vendim të cilin duhet ta plotësojmë në këtë mbledhje të Kuvendit. Para se me hy në rend të ditës, hapim diskutim.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. më lejoni të ju përshëndes të gjithë të pranishmëve. Unë e kam një kërkesë, që nëse ka mirëkuptim, me kryesuesin dje kam bisedu pak, do të bisedojmë edhe pas mbledhjes, se kjo mbledhje e Kuvendit mbahet ne prag të zgjedhjeve nacionale, që uroj për këtë zgjedhje. Megjithatë, kërkesa ime është që ta ruajmë fjalorin në Kuvend, të fokusimi në pikat e rendit të ditës, që mos t'i japim zgjërime politik.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A ka ndonjë çështje tjetër? Pasi që nuk ka, vazhdojmë me rendin e ditës. Për këtë seancë kemi paraparë këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e raportit të komisionit për përgatitjen e draftdokumentit për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, për vendosjen e trafave elektrike.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, për vendosjen e trafave elektrike.**
7. **Informatë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për manifestimin tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut 2026".**

Kam edhe një kërkesë, që të jet pikë shtesë e rendit të dites ky që u kthi nga ministria për rishqyrtim. Fjala është për **Propozim vendimin për plotësimin e Vendimit Nr.01-110/05-381, të datës 31.03.2026 për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë.** Duhet me qenë në format të marrëveshjes, që e parash ligji, edhe me qenë në tri gjuhë. E keni edhe shkresën e ministrit në material.

zn.Miliate Ajeti, drejtoreshë e Financave: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, edhe unë e kam një propozim-vendim për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2025 në vitin 2026, se dje u lejua kjo dhe nuk deshta me e vonu ma shumë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që të miratohet rendi i ditës me këto pika të propozuara? Nga të gjithë të pranishmit u miratua rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A ka me diskutu për këtë pikë? Jo. Nga të gjithë të pranishmit u miratu procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e raportit të komisionit për përgatitjen e draftdokumentit për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011**

z.Fatlum Demiri, kryesues i komisionit për ndryshim plotësim të Statutit: Faleminderit kryesues për fjalën e dhënë. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ju falënderoj fillimisht që na keni dhënë besimin me qenë anëtarë të komisionit për ndryshim-plotësim të statutit. E falënderoj edhe komisionin dhe e konsideroj që e kemi bërë një punë të mirë. Jemi mundu me bërë ndryshime të cilat kanë qenë të nevojshme, gjithherë bazuar në ligjet e aplikuara në Republikën e Kosovës dhe në udhëzimet administrative. Komisioni ka pasur gjashtë takime dhe e kemi përgatit draftin, të cilin e kemi lëshu në konsultim publik. Ky konsultim ka zgjatur 30 ditë, bazuar në udhëzimet administrative. Debatimi me qytetarë është mbajtur në sallën e kuvendit. Kanë qenë diku rreth 30 qytetarë. Kemi pas kërkesë nga qytetarët, ku njëra nga këto ka qenë që 5 Maji, Dita e Dëshmorëve në Komunën e Vitisë, të jetë ditë feste, mirëpo të punohet. Në statutin bazë ka qenë ditë feste, por ka qenë pushim. Propozuesi i kësaj e ka arsyetuar këtë me atë se 1 Maji ditë pushimi, 9 Maji ditë pushimi, plus 5 Maji, e po humbin nxënësit shumë mësim. Ne si komision e kemi vlerësuar këtë dhe kemi menduar që kërkesa ka qenë e arsyeshme dhe i propozojmë kuvendit që 5 Maji të jetë ditë feste në Komunën e Vitisë, por të punohet në institucionet komunale. Tani ju njoftoj për secilin nën që kemi menduar me ndryshu.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: E vetmja Komunë e Vitisë për Ditën e Dëshmorëve nuk ka punë. Edhe para disa viteve kam pas pyetje nga gazetarët pse nuk punohet në këtë ditë, kur në krejt komunat e

Kosovës shënohet Dita e Dëshmorëve dhe punohet, ndërsa ne e kemi pas në statut dhe nuk kemi pas telashe. Krejt institucionet tjera kanë punu, si gjykata etj., edhe unë e kam përkrah këtë ndryshim.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A do të shënohet ditë festive apo ditë e shënuar. Duhet të dimë si do të shkruhet.

z.Fatlum Demiri, kryesues i komisionit për ndryshim plotësim të Statutit: Kryesues, ne e kemi ndryshu vetëm aty ku thuhet nuk punohet. E kemi propozu të punohet, e tash siç e propozoi ju, ne edhe teksin tjetër e ndryshojmë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Unë kam mendu se u mytem tu e përmend. Në rast se thojmë se, Dom Mikel Tarabulluzi është festë, 2 Korriku, pse mos me e shti edhe Pozharanin, shkollën e parë shqipe me alfabet të Manastirit? Vetëm që duhet me e gjetë datën se kur është, dhe kjo me pas karakter. Në rast se kurgja nuk bëjmë, duhet me e gjetë datën që me ia dhanë atë rëndësinë e vet historike që e ka pas, dhe duhet me e shti aty ku është 2 Korriku.

z.Fatlum Demiri, kryesues i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: 5 shkurti në statutin bazë shkruan, dita e shkollës së parë shqipe në Kosovë, festë publike në të cilën festohet nga qytetarët e Komunës së Vitisë, por punohet në organet komunale.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ama, në rast se e shtimë në statut, tani e ka obligim statutar edhe në aspekt financiar edhe në aspekt tjetër.

z.Illir Zuka: Puna e parë që ka qenë dashur mu bë në statut, e kemi logon në statut, që sa pjesë e Komunës sonë. Ka qenë dashur me punu në logo. Duhet me ndryshu logon.

z.Fatlum Demiri, kryesues i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: Ilir, për me e ndryshu logon duhet me qenë vendim tjetër i kuvendit dhe ka procedura tjera. Ne e kemi propozu këtë, ndërsa ju jeni ata që e ndryshoni dhe e plotësoni këtë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Nëse e caktojmë datën e shkollës së parë shqipe, se e di unë qysh bëhen festat tjera tu lëshu vendime, kemi drejtë a po nuk kemi drejtë. Kështu, kur ta ki me statut, drejtori thotë: “Unë i ndaj kaq mjete për shkollën e parë shqipe në Pozharan”, dhe këtu nuk ka problem. E përderisa nuk e kemi në statut, është problem.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: 5 Shkurti, Dita e Shkollës së Parë Shqipe. Takimet e Dom Mikelit mbahen në muajin shtator. Cila është kjo, ose a e bëjmë te 5 Shkurti: “Shkolla e parë shqipe në Kosovë, në Pozharan dhe në Stubëll”? A jeni dakord me e shti kështu? Të gjithë janë dakord.

z.Arian Alidema, anëtar i komisionit: Neni 6 i Statutit bazë, shkronja d, me u riformulu duke e përcaktu ditën saktë dhe me shtu një shkronjë tjetër për Stubllen.

z.Jakup Demiri: Kjo puna e 5 Majit është ditë festive për qytetarët, por punohet. E di që kremtimi dhe festimi kanë një karakter të njëjtë, po shënimi i ditës nuk ka të bëjë me festim; me festu atë ditë. Unë nuk po e di, mendoj që duhet me u shkru më mirë formulimi, sepse disa janë të festume, disa të shënueme, dhe duhet me ditë si me e shkru.

z.Illir Zuka: Pajtohem me Jakupin dhe me kryesuesin që të jetë ditë e shënuar dhe e përkujtuar nga qytetarët e Komunës së Vitisë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Fatlum, ti e din që e kemi pas një kërkesë mandatin e kaluar prej ish Shtabit të Brigadës 173, ku kanë bë kërkesë me qenë në statut vetëm si datë e shënuar, kur është themelu brigada, të jetë ditë e shënuar, nuk ka obligim.

z.Fatlum Demiri, kryesues i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: Me kërkesën e kryesuesit dhe të anëtarëve të tjerë, do të hyjë edhe kjo kërkesë në ndryshim-plotësim të statutit.

z.Illir Zuka: Unë deshta me shtu diçka tjetër me diskutu. Edhe vitin e kaluar për këtë temë e di që është e ndishme, po na jemi tu e pa që në “Flakadakun e Karadakut” mbi 90% të familjeve të dëshmorëve nuk marrin pjesë. Tash a na ka mungu guximi a çka është, nuk e di. Unë mendoj që u kanë dashtë me hi me punu edhe në këtë drejtim, dmth ky “Flakadaku i Karadakut” mos me e bë ndarjen e dëshmorëve shumë. Më rëndësi i japin

“Flakadaku të Karadaku” se Ditës së Dëshmorëve që e kemi një ditë tjetër. Unë po besoj që jemi tu bë padrejtësi ndaj të gjitha atyre familjeve që kanë të rënë, që kanë në varrezat e dëshmorëve familjarë të rënë. Qysh me ba zgjidhje, çka me ba, ajo është pjesë e komisionit, ju kishim ndihmu të gjithëve në çfarëdo forme. Unë kam pas një propozim dhe e di që kam pas edhe presion prej familjeve pse e kam diskutu. Unë e kam marrë votën e qytetarëve për me i ngrit këto çështje. Unë kam mendu që kësaj here në statutin e komunës u kanë dashtë me qenë jo “Flakadaku i Karadaku”, po “Flakadakët e Karadaku”, edhe me i përfaqësu të gjitha familjet e dëshmorëve, edhe me u shënu si ditë. Se na po e bëjmë ndarjen e dëshmorëve, thjesht jemi tu i nda: një dëshmor po ja ndajmë 20 mijë euro, e një tjetri 500 euro. Ata kanë ra për një qëllim që sot ne e gëzojmë këtë liri. Pse na mungon guximi? Na e dimë si festojmë, pse nuk është marrë ky guxim? Personi në fjalë për të cilin jam tu fol, jam i bindur që edhe ai ish pajtu me këtë propozim temin, e jo për interesa të dikujt tjetër. Pse po i ndajmë? Dikun 20 e sa dëshmorë i ka Komuna e Vitisë, po i lam anash. Unë menoj po e leni anash ju si komision pikën kryesore që është dashtë me u bë llogo e komunës, edhe këto tjerat janë kanë për me i mbulu apetitet tjera. Përndryshe, nëse nuk prekim na në këto, një dëshmor, një ditë për një dëshmor të rënë po ja ndajmë 20 mijë euro, e dikujt tjetër organizim vetanak. A po muj me bë diçka, a po jo? Na e dimë që kemi mbi 20 vjet që nuk ja kemi shënu ditën e rënies. Në Sadovinë tash ja kanë bë një bust, e 20 vjet nuk ju ka shënu dita e tij. Është gjynah. Është në Sadovinë të Çerkezve, është gjynah me bë ksi ndarje. Kështu që unë kisha propozu me marrë guximin me i thirr familjet e dëshmorëve, veteranët e luftës, me diskutu edhe njëherë. “Flakadaku i Karadaku” i takon të gjithë dëshmorëve. Komuna e Vitisë kur t’i bjen, krejt shoqëria me i përfaqësu të gjithë dëshmorët. A e dini sa rëndë është? Unë e di që drejtori sa rëndë e ka kur del me mbajt fjalim, kur 95% të familjeve të dëshmorëve nuk i ka në sallë. Mendoj që ka qenë dashtë me u bë diçka këtu.

z.Fatlum Demiri, kryesues i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: E kemi diskutu edhe ne si komision, mirëpo kemi konstatu se është temë e ndishme dhe nuk kemi respekt me i thirr këta akterë dhe me e ndryshu. Por, megjithatë, fjala përfundimtare e draftit final e merr Kuvendi deri më datën 29 të këtij muaji. Akterët kryesorë që kanë autoritet më shumë se komisioni mund me pas takime, me pas dakordim dhe me propozu. Propozimin e bën anëtar i Kuvendit, komisioni nuk e ka propozu, por ia propozon Kuvendit, dhe kjo mund të ndryshohet.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Munden tre shefat e grupeve parlamentare mu çu me thanë që ne e përkrahim plotësim-ndryshimin, kanë hy vërejtjet e dhëna në KPF dhe propozojmë që “Flakadani i Karadaku”, Grupi i këshilltarëve të LDK propozon që jo me u qujt “Flakadan”, po “Flakadakët e Karadaku”. Qohet shefi i PDK, e përkrah ai i LVV, edhe kjo kalon në këtë formë.

z.Basri Aliu: Është çështje e ndishme kjo, po komisioni as pak nuk ka faj në këtë drejtim, sepse komisioni ato që i kërkohen i shqyrton. Komisioni i ka pas kërkesat prej ekzekutivit, ka pas prej qytetarëve, këtë kërkesë nuk e ka pas dhe nuk e ka shqyrtu. E nëse duam tash na me ba diçka tjetër, atëherë është mirë me marrë një mendim edhe prej shoqatave të dala nga lufta, edhe ata me japë një propozim, në mënyrë që në Kuvend jemi ata që e bëjmë ndryshimin e tij. Është mirë që ata me e ngrit këtë çështje.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Fatlum, a ka pas kërkesë Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve për këtë temë.

z.Fatlum Demiri, kryesues i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: Jo, nuk kemi pas kërkesë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Mu më ka ra edhe ma herët kur kam diskutu. Është temë e ndishme. Kanë kalu 26 vite dhe, pas 26 vitesh, me shku në Kuvend me e propozu e me qu dorën, bëjmë gabim të madh. Këtë punë duhet me e iniciu shoqatat; ato me marrë iniciativën dhe me i ba kërkesë komisionit. Shoqatat duhet me ba një harmonizim. Tash, na me e miratu nuk shkon veç me një propozim, se mundemi me e qu dorën, mirëpo nuk ban.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve e ka këtë dispozim.

z.Illir Zuka: Është e vërtetë, kryesues, e din edhe ti se e kam propozu. E din edhe ata që e kanë ndërmjetësu. Shoqata e familjeve të dëshmorëve e kanë diskutu, po nuk kanë mujt me ba zgjidhje, se ai nuk lëshon pe. Si

familje, na jemi mbi krejt; jemi institucion, jemi të zgjedhurit e popullit. Na mujmë me ba këtë, por nuk e kemi vullnetin. Jemi në rregull, vazhdoj me juve. Unë kam pas kontakt me këto familje, ke pas edhe ti, e din.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë e pyeta: "A keni pasë kërkesë?" Tha: "Jo." E çka keni folë individualisht? Unë kam folë me bacin Qemal, edhe ai tha që nuk ka ma vullnet, pas 26 viteve, me marrë këtë iniciativë për me ndryshu.

z.Basri Aliu: Pa kërkesë të shoqatave nuk kisha thanë.

z.Fatlum Demiri, kryesues i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: Po vazhdoj te neni 10 i Statutit. Bazë e statutit juridik-ligjor të komunës kemi propozuar germën **f**, me të cilën thuhet: "Ka cilësinë e punëdhënësit, punëson shërbyes civilë dhe të emëruar politikë." Ne kemi propozuar që të thuhet: "Ka cilësinë e punëdhënësit, punëson kategorinë e zyrtarëve publikë", sepse Ligji për Zyrtarët Publikë e ka zëvendësuar Ligjin për Shërbyesit Civilë dhe të Emëruarit Politikë. Në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, këtë shtesë e ka kërkuar MAPL-ja, pasi ne e kemi dërguar draftin në MAPL për vlerësim paraprak. Vlerësimi është bërë dhe shkresa zyrtare ende nuk më ka ardhur, është në kabinet të ministrit, por në telefon më kanë thënë me e shtu këtë. Te neni 13 i Statutit, bazë gjatë themelimit të këshillave të fshatrave, Statuti thotë se duhet me qenë të përfaqësuar në mënyrë proporcionale nga partitë politike në këshillin e fshatit. Ndërsa Rregullorja për Organizimin e Këshillave të Fshatrave, të cilën e kemi miratuar në Kuvend, thotë se anëtarët e këshillave të fshatrave nuk duhet me qenë në pozita udhëheqëse të partive politike. Materialin e keni marrë me kohë, d.m.th. Statutin bazë dhe ndryshimet. Jam në dispozicionin tuaj për pyetje dhe përgjigje shtesë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A ka me diskutu për këtë? Pasi që nuk pat për diskutim: a jeni që te shkon në Kuvend kjo pikë e rendit të ditës? Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Para jush e keni propozim-vendimin përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. E keni materialin. E gjithë kjo ka qenë një procedurë që është zhvilluar nga përbërja e kaluar. Në momentin e nxjerrjes së njoftimit përfundimtar ka ardhur ajo shkresë, me të cilën disa kompetenca i janë marrë komunës dhe, për momentin, procedura është pezulluar deri sa të kryhen zgjedhjet. Prandaj, unë, sa e kam pa dokumentacionin, ai ka qenë i kompletuar. Ka qenë edhe raporti i komisionit, të cilin me siguri e keni edhe ju. Tani është faza përfundimtare, për të cilën ju ka ardhur propozimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim. Nëse keni pyetje shtesë, i kemi këtu dhe mund të japim sqarime të mëtejshme.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: I kemi dy pika të njëjta.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Po dy pika janë, janë kanë me një ankand, me një përbërje të komisionit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapim diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Jakup Demiri: A duhet me pas komisioni në këto pika naj komision tjetër? Se komisionit të mëparshëm i ka përfundu mandati.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Komisioni e ka vlerësu, nuk ka nevoj për komision tjetër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Është vlerësu, edhe janë kanë procedurat e ankesave, jane edhe raportet. Për 20 vite te koka parapa pagesa.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Janë edhe raportet e komisionit këtu. Ka pasur edhe ankesa, por janë shqyrtuar. Ai që ka bërë kërkesë për me i marrë këto, ne e kemi qitë në ankand publik. Kanë konkurru palët e interesuara dhe ai ka ofru çmimin më të lartë, prandaj i ka tejkalu të tjerët në garë. Çështja ka qenë se ka pasur ankesë nga Bardhok Jetishi, i cili kishte thënë se unë do t'ia jap komunës fitimin me përqindje, në mënyrë proporcionale. Mirëpo, në konkurs dhe në ankand ne nuk e kemi paraparë një kriter të tillë. Prandaj,

nuk ka qenë e mundur të merret parasysh si kriter vlerësimi. Më pas ai e ka bërë ankesën, por komisioni e ka shqyrtuar dhe ia ka refuzuar atë.

z.Basri Aliu: Për çfarë veprimtarie janë dhënë këto parcela?

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Janë të cekura edhe veprimtaria për çka janë dhënë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës, që të shkon për në Kuvend? Me votat e të gjithëve kjo pikë shkon në Kuvend.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale

Ne i diskutum të dyjat, hapi debat edhe për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Pasi që na u bashkëngjiti Hida, po ia bëj këtë pyetje e cila u parashtrua më herët: a ka nevojë me qenë prezent komisioni, pasi që komisioni e ka bërë raportin përfundimtar? Përgjigjja ime ka qenë se nuk ka nevojë, por po e kërkojmë edhe mendimin tuaj.

zn.Hidajete Aliu nga Drejtoria për Kadastër: Jo, nuk ka nevojë me qenë komisioni më, sepse e ka bërë raportin. Pasi të miratohet në Kuvend, bëhet një kontratë në mes të kryetarit dhe përfituesit.

z.Jakup Demiri: Çdo vendim i marrë në Asamblenë Komunale, i cili finalizohet brenda atij mandati, nuk vlen për pjesën tjetër të Asamblesë.

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Ne kemi pasë me e shti në Kuvend më herët, por pas marrjes së shkresës nga MAPL-ja, unë kam mbrojtur që, në momentin kur thuhet se zgjedhjet janë shpallur, ka ardhur kërkesa që të gjitha pronat të pezullohen. Jo të ndërpriten, por të pezullohen. Unë mendoj që ka qenë dashur me u pezullu procedura deri në përbërjen e re. Në përbërjen e re duhet me iu shtrë Kuvendit, sepse atë punë të Kuvendit të kaluar duhet me e njoft ky Kuvend, me të gjitha çka mundet me ndodhë. Obligimi ynë është me e përfundu procedurën, sepse e kemi lanë në aktin final. Prandaj po e çojmë në Kuvend; nëse doni, mundeni edhe me e kthy.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që të shkon edhe kjo pikë në Kuvend? Me votat e të gjithëve edhe kjo pikë shkon për Kuvend.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, për vendosjen e trafove elektrike

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Kemi dy propozime. Njërenë në Goshicë e tjetren në Kabash. Janë me kërkesa të KEDS-it. Kryesues, për Ramjan, se kam harru, kam fol me KEDS, kanë met me e rregullu edhe në Ramjan.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që të shkon në Kuvend pika e pestë e rendit të ditës? Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për kompaninë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a KEDS në Viti, për vendosjen e trafove elektrike

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që edhe kjo pikë të shkon në Kuvend? Nga të gjithë të pranishmit edhe kjo pikë e rendit të ditës shkon për Kuvend.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Informatë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për manifestimin tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut 2026"

z.Valmir Sahiti, drejtor i Drejtorisë për Kulturë: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Para jush e kemi sjellë informatën mbi aktivitetet e Manifestimit Tradicional Kulturo-Sportiv "Flakadani i Karadakut 2026". E kemi kalendarin e aktiviteteve, i cili paraqet një ngjarje të madhe kulturore dhe sportive në Komunën e Vitisë, në të cilën kanë marrë pjesë nxënës, artistë, shkrimtarë dhe grupe të ndryshme nga të gjitha trojet shqiptare. Materialin e keni marrë me kohë, në të cilin cekën të gjitha të dhënat lidhur me këtë manifestim. Për pyetje shtesë, jam në dispozicionin tuaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Jakup Demiri: Aktivitetet dhe shpenzimet në proporcion me numrin e dëshmorëve a e keni kshyrë naj here.

z.Valmir Sahiti, drejtor i Drejtorisë për Kulturë: Ky është një manifestim zyrtar, kështu e kemi gjetur tash e 25 vjet dhe na duhet me e mbajt, jo me e anashkalu. Nëse i bëjmë krahasimet me manifestime që janë shumë më të vogla për sa i përket aktiviteteve, si p.sh. Hasi, ku një festival kushton diku rreth 30 mijë euro, këtu e kemi një kosto më të vogël. Por, duhet me qenë i sigurtë dhe me i falënderu edhe Plus TV, e cila nuk ka pasur kontratë, por i ka kryer punët pa kontratë. Po ashtu edhe kompania Vizual Media nuk ka pasur kontratë, dhe disa banerë dhe materiale të mirënjohjes janë realizuar pa kontratë. Sa i përket çështjeve të tjera, veçanërisht për dëshmorët, brenda mundësive që i kemi pasur, jam munduar që kërkesat e familjeve të dëshmorëve dhe të shoqatave, sa kemi mundur, mos me i kthyer mbrapa.

z.Basri Aliu: Ky festival ka edhe karakter të përgjithshëm, e zhvillon kulturën dhe sportin. Domethënë, e kemi lanë një emër dhe tash po thirrmi rreth atij emri. Nuk e ka qëllimin vetëm të emri, por e ka edhe qëllimin e zhvillimit të kulturës dhe sportit. Prandaj, në këtë aspekt duhet me u shiku mundësia për ndryshim të emrit. Edhe unë jam pro, por problemi është që dikush tjetër duhet me e marrë iniciativën. Sa i përket dëshmorëve, të gjithë e kanë pasur një qëllim dhe për këtë nuk kemi çka me diskutu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që kjo pikë e rendit të ditës të shkon në Kuvend? Me votat e të gjithëve kjo pikë e rendit të ditës shkon në Kuvend.

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

8. Propozim vendim për plotësim të Vendimit Nr.01-110/05-381, të datës 31.03.2026 për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë

U kthy nga ministria. Duhet me plotësu këtë. A ka për diskutim? Pasi që nuk ka: a jeni që edhe kjo pikë e rendit të ditës të shkon në Kuvend? Nga të gjithë të pranishmit u mirtatu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e nëntë e rendit të ditës:

9. Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2025 në vitin 2026

Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të shkon në Kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës? Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi herave tjera.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi
